



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:070729
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639748

Ac.nr.7617/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.K nga fshati R....., Komuna R..... dhe D.M nga fshati O....., Komuna R....., të cilët me autorizim i përfaqëson A.M avokat në Rahovec, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit- Drejtoria Komunale e Arsimit, baza e kontestit: Kompensim i pagave mbi bazë të Kualifikimit, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Rahovec, C.nr.199/2022, i datës 20.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themelë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Rahovec, C.nr.199/2022, i datës 20.06.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.199/2022, të datës 20.06.2022 ka vendosur si në vijim:

“APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve B.K dhe D.M, si dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që:

1.Paditësit të parë B.K nga fshati R....., Komuna R....., me fakultet katër vjeçar në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri 31.12.2020, 27 % nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67 €, duke zbritur shumën prej 58,32

që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur për çdo muaj nga 55,45 euro për gjithsej 44 muaj, shumën e përgjithshme prej 2,439. 80 €.

2.Paditësit të dytë D.M nga fshati O....., Komuna R....., me fakultet katër vjeçar në emër të kompensimit për licencim për periudhën kohore prej 01.09.2017 e deri 31.12.2020, 27 % nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67 €, duke zbritur shumën prej 58,32 që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur për çdo muaj nga 55,45 euro për gjithsej 40 muaj, shumën e përgjithshme prej 2, 218. 00 €, apo në shumë të përgjithshme prej 4, 657. 80€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (05.04.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, SI ME BAZË.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditëses t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 379,80 € me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, përmes të autorizuarës së saj, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, në atë mënyrë që ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, apo ta prishë dhe këtë çështje juridike ta kthejë në rigjykim ose rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet e pa bazuar, aktgjykimi ankimor të vërtetohet, ndërsa e paditura të detyrohet që ti mbuloj shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 05.04.2022 në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e diferencës në pagë sipas licencimit, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykim e atakuar C.nr.199/2022, të datës 20.06.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykitimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykitimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas administrimit të provave në shkresa të lëndës, nga kontrata me nr. te protokollit 1738/2, të datës 01.09.2015, e lidhur ne mes të paditurës dhe këtu paditësit B.K, është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, se paditësi është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, licenca me nr....., të datës 26.12.2012, nga diploma e lëshuar nga UP Hasan Prishtina- Fakulteti i Edukimit me nr....., të datës 09.06.2015, vërtetohet se paditësi është diplomuar në drejtimin Teknologji - Informatikë, kurse nga Lista e pagave Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet

paga bazë të cilën e realizon paditësi B.K. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se paditësi D.M sipas kontratës me nr. prot....., të datës 01.09.2017, është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe është i pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt, licenca me nr....., të datës 31.05.2021, nga diploma e lëshuar nga UP Hasan Prishtina- Fakulteti i Edukimit me nr....., të datës 19.12.2017, vërtetohet se paditësi është diplomuar në drejtimin Programi fillor, kurse nga Lista e pagave Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet paga bazë të cilën e realizon paditësi D.M. Mbi këtë bazë ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve duke u bazuar në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, pika 3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017. Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së. Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 156 € për përpilim padisë dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 21 €, për përfaqësim në një seancë shumën prej 202.80 €, apo në shumë të përgjithshme prej 379.80 €.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimi se kompensimi i tillë nuk parashihet me Ligj të Punës e as me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj gjykata gabimisht ka vendosur në këtë çështje nuk qëndron, sepse Ligji i Punës në raport me këto kategori referohet në Kontratë Kolektive gjë që kjo sipas Kontratës Kolektive parashihet dhe se mbi këtë bazë paditëseve i takon kompensimi.

Mungesa e linjës së veçantë buxhetore nuk nënkupton lirim nga përgjegjësia e të paditurës pasi raporti në mes të nivelit lokal dhe atij qendror nuk afekton në të drejtën e paditëses për kompensim.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditëseve të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditëseve. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditëseve.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë peshë në vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton të provohet fakti se paditësit B.K me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. të protokollit3, të datës 26.12.2012, i është pranuar kërkesa për licensim, po ashtu paditësit D.M me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësit me nr. të protokollit, të datës 31.05.2021, i është pranuar kërkesa për licencim.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 në pikën 1 ka vendosur që: *Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësit kanë diplomë universitare, ku edhe kanë marrë titullin bachelor, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet se paditësit janë paguar në bazë të kualifikimit me fakultet në shumën prej 58.32 euro.

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditësve i është aprovuar kërkesëpapia edhe lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licensimit, ani pse Gjykata e Shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga *Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, GJA-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023*, ku është përcaktuar se për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008.

Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 deri në periudhën kur edhe është shfuqizuar, dhe ky vendim që është dashur që të zbatohet që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, e që e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim i'a ka mohuar paditësve një të drejtë që iu ka takuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se çështja e asaj se paditësit paguhet sipas kontratës së punës që është lidhur dhe se me konkurs nuk është përcaktuar se mësimdhënësit paguhet sipas licensimit, ky pretendim është tejet irrelevant, pasi që kemi një Vendim të vetë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka pasur karakter detyrues dhe si i tillë është dashur detyrimisht të zbatohet, pavarësisht asaj se çka është përcaktuar me kontratë sepse me kontratë përcaktohet fillimisht paga bazë, ndërsa sa i përket konkursit, kjo është çështje që më tepër ka rëndësi të thirrjes për aplikim të personave të interesuar dhe informim i kushteve që duhet të plotësohen për tu punësuar në institucionin e caktuar, por asnjëherë nuk mund të jetë përcaktues i pagës, shtesave apo edhe

kushteve të tjera të punonjësit që përcaktohen me Ligj apo vendime të organeve të Republikës së Kosovës.

Pretendimi ankimor i të paditurës se për periudhën kohore pas datës 18.04.2020, kërkesa e paditësve është paraqitur pas afatit dhe është e parashkruar, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nuk ka qenë në fuqi, është i paqëndrueshëm, për faktin se paditësit padinë e kanë parashtruar në gjykatë me datë 05.04.2022, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ka qenë në fuqi deri me datë 18.04.2020, dhe në bazë të nenit 45 të kësaj kontrate është paraparë se “ *Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit, Këtë fakt e ka vërtetuar edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 2, parag.IV), ku parashihet se: ‘‘Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017-21.01.2021’’.*

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7617/2022, me datë 25.04.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca Dula, d.v.